

Dalës-izlaze

Nr. - 1 - 21

Br.

16.02.2023

OPILLO OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq



Kuvendi Komunal i Obiliqit

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI

I mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, të mbajtur më 02.02.2023 në ora 11:00, në sallën e KK-së.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), dhe Biljana Spasic (SL).

Munguan këta anëtarë: Shaip Paloja (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Ajshe Haliti Pllana (LVV) dhe Ratomir Ristic (SL).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi, Nënkryetari i Komunës- Ibush Mjekiqi, drejtorët komunal, përf. e KFOR-it, OSBE-ja dhe Demokracia plus.

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i kërkesës të anëtarëve të Kuvendit Komunal me numër të protokollit I-2548

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 17 vota të anëtarëve prezent, dhe kalohet në r.d.

I. Pika e parë e rendit të ditës.

Kryesuesja- Paraqet shqyrtimin e kërkesës dhe vazhdon, duke pasur parasysh shqetësimin e madh të qytetarëve tanë pas rivlerësimit të pronave nga ana e Ministrisë së Financave kur jemi në një gjendje mjaft të rënduar ekonomike me inflacion të lartë jemi këtu sot për të rishikuar të gjitha rrugët e mundshme me qëllim të situatës së palakmueshme të qytetarëve tanë. Ligji i tatimit në pronën e paluajtshme nr.06L-005 të dt.15.02.2018, neni 9 e përcakton që kuvendi komunal i çdo komune i cakton normat tatimore prej 0.15 deri në 1 kurse vlerësimin e pronave e bene ministria e financave njëherë në çdo 3 vite apo 5 vite, pra komuna nuk bënë vlerësimin e pronave të tatimit në pronë.

Te nderuar anëtarë të kuvendit dhe të pranishëm fjalën ja japi kryetarit të komunës, që të jep sqarimet apo rekomandimet e veta lidhur me këtë situatë.

Kryetari i Komunës – pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se në e kemi analizua gjendjen aktuale për shkak të rritjes së çmimeve dhe inflacionit, dhe fatmirësisht komuna vitin e kaluar qind de për qind kemi tejkalua të hyrat vetanake, në jemi të gatshëm si komune nëse përmirësohet infrastruktura ligjore dhe të kemi baze ligjore nga Ministria e financave, të bëjmë faljen e borxhit deri në 100.00 € për qytetarët e komunës tonë. Në jemi në

kontakt me Asociacionin e komunave dhe me koleget-kryetaret komunave, e kemi parë që Podujeva, Prishtina, Lipjani po vazhdojnë me mbledhje të jashtëzakonshme lidhur me këtë gjendje dhe marrin rekomandime, po ashtu edhe ne jemi të gatshëm të bëjmë faljen e borxhit deri në 100.00 € për qytetaret e komunës tone.

Kryesuesja-pas kësaj fjalën ju dha shefave të grupeve parlamentare

Enver Gashi- pasi i përshëndeti të pranishmit, tha, në si grup parlamentar i këtij kuvendi e ndajmë shqetësimin bashkë me qytetaret tanë që kjo vlerë e tatimit për vitin 2023 është e lartë sepse kemi inflacion deri 20% dhe njëherit sapo kemi dale nga pandemia, ne i kemi bere dy rekomandime për ministrin lidhur me tatimin e pronave, si vijon

1. Që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të plotësoj infrastrukturën ligjore, ku Komuna e Obiliqit është e gatshme për lirimin e pagesës, sipas faturave të qytetareve nga tatimi në pronën e paluajtshme deri në 100 euro.
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, vendimi për Ri-vlerësimin e pronave të pezulloj dhe qytetaret të paguajnë vlerën e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023 ashtu si ka paguar në vitin 2022.

Sami Ahmeti- pasi i përshëndeti të pranishmit dhe njëherit ju falënderua të pranishmeve për pjesëmarrje në këtë takim, me që rast nënkuptohet se interesi i qytetarit është ai që na preokupon secilin prej nesh, shpreh mirënjohjen time për koleget nga opozita që mundësuan takimin e kësaj seance duke vënë nënshkrimet e tyre siç e parasheh ligji, shpresoj se që fryma e diskutimeve pa qëllime të përfitimeve partiake të mbizotëroj dhe të marrim një vendim apo të japin rekomandim të shkoj në të mirë për qytetaret e Obiliqit. Para se të paraqes propozimin tonë, në si lëvizje si e mendojmë zgjidhjen e kësaj duhet me parë të dimë problematikën dhe veprimet që na ka sjell deri në këtë pikë. Tatimi në pronë janë të hyra që i inkason komuna dhe komuna është ajo që i menaxhon dhe i kthen në investime për qytetaret tanë. Ligji i tatimit në pronën e paluajtshme nr.O6L-005 të është baza ligjore për vjeljen e tatimeve i miratuar në vitin 01.10.2018, nuk behet fjalë për ndonjë ligj të ri por për ligjin e miratuar në vitin 2018, ndërsa si akt nënligjor është Udhëzimi Administrativ MF-NR. 08/2019 i cili e cakton metodologjinë e vlerësimit dhe qëllimet e tatimit në pronë, ku nëni i 10 pika 1. citoj " *Departamenti i Tatimit në Pronë kryen një vlerësim të përgjithshëm një herë në çdo tre 3 vjet....*" ky vlerësim është bere si është theksuar në ligj. U theksua çka ka mundësi prej parafolësve, në konsiderojmë se K.Obiliqi ka mundësi faljen e këtij borxhi deri 100 euro. Prandaj ne jemi që të mirët një rekomandim ndërsa MF-ja ka mundësi të fusë ndryshimin në ligjin që janë duke punuar në këtë drejtim dhe të futen rekomandimet e komunave për ndryshim. K.Obiliqi është komuna që ka mundësi të beje këtë pasi ka buxhet me të madh për kokë banori, në i falënderojmë të gjithë për pjesëmarrje dhe është e mjaftueshme që të marrim një rekomandim dhe ministria ka mundësi ta fusë këtë ndryshim në ligjin që janë duke punuar. Se në nuk kemi mundësi të marrim vendim për këtë qëllim për faljen e borxheve por të marrim rekomandim dhe ministria ta fusë atë gjatë ndryshimit të ligjit. Ne , e ritheksoj dhe i falënderojmë secilin për iniciativën tonë dhe të keni mirëkuptim për propozimin tonë.

Ajet Berisha- proceduralisht kish qen mirë fillimisht propozuesi të marr fjalën pastaj mu kyç në të tjerët , me nënshkrimin që e kam dhënë në këtë kërkesë , pajtohem për rekomandimin për faljen e borxhit që ti shkoj ministrisë, me shku nga ky kuvend për shkak të gjendjes jo të mirë të popullatës dhe ngritjes së tatimit në pronë por mirë kishte me qen me pas një analizë nga ekzekutivi që po mungon se sa po humbim në si komune apo preken projektet nga ana e komunës, sa qytetarë preken nga rekomandimi jone, kom prit një analizë të shpejt nga ekzekutivi që po mungon dhe pritet që në të bëjmë këtë rekomandim që do të vlej nga ministria, sepse jemi të befashuar nga ky vlerësim i pronave sado me qene real nuk është përcjell vlera e uljes tatimore që në si kuvend komunal me pas tatim real me gjendjen financiare të popullatës.

Kryetari i Komunës- vitin e kaluar në muajin shtator i kemi tejkalua të hyrat vetanake nuk kemi nxjerr shifër reale duke llogaritur se këto mjete nuk do të prek ndonjë projekt por edhe nëse preket ndonjë projekt ja vlen nëse këto mjete shfrytëzohen për të mirë të qytetareve tone dhe të kalojmë situatën aktuale .

Kryesuesja- i njofton të pranishmit me rekomandimin e Enver Gashit dhe kërkon nga Sami Hamiti të përsërisë edhe një herë rekomandimin e propozuar .

Sami Ahmeti- e mirëkuptoj rekomandimet e juaja mirëpo paraprakisht kur e kemi bërë këtë iniciativë ne e kemi shqyrtua bazën ligjore dhe kemi marr zotimin e ministrit që mund të bëhet diçka në këtë fushë, ne mund të bëjmë edhe rekomandime tjera por të cilat mbesin në fazën e rekomandimeve që nuk mundin të realizohen, dhe kur kemi bisedua me ministrin, na është thënë se çka kërkohet nga KK-ja të bëjmë rekomandimin që të fus në ligjin që është duke u punuar, na është thënë që komunave do të lejohet falja e borxhit deri 100 euro të gjithë tatim paguesve të asaj komune. Ligji ka mu punua dhe të njëjtën kohë kemi marr zotim dhe do të do të ulet norma prej 0.15, në si kuvend dhe shumica tjera të komunave kanë shkuar me rekomandime dhe norma minimale dhe kjo ka të bëjë me ligjin e aprovuar me 2018 dhe është dashtë të bëhet vlerësimi, dhe prej shumë komunave dhe kryetareve është thënë se është vlerësim reale por për mi ik kësaj, ne kemi marr zotimin që nëse kuvendi i Obiliqit të merr rekomandim për faljen e borxheve dhe në kërkim që të shkohet me këtë propozim sepse e kemi zotimin e ministrit të MF-se.

Enver Gashi- ne flasim sot në këtë kuvend, flasim në të tashme sot çka kemi. Në ligjin nuk e kontestojmë por rekomandojmë, këto rekomandime që i dhamë na, janë propozime tona nëse ju keni diçka të fshehtë ne nuk e dimë. Gjithçka çka bëhet në ministri është e ministrisë ndërsa të komuna bie të na, ligjin nuk e kontestojmë por na takon gjithëve çfarë ne po flasim për sot dhe këtë që çka po thua ti sot po me duket si klandestin. Askush spe vet askënd sepse ligji është i Kosovës dhe jemi të thirrur ta zbatojmë.

Sami Ahmeti- ndoshta u keqkuptova por propozimi i ministrit ka qenë publik, është propozim dhe jo që më ka thënë mua direkt edhe fakti që jemi ardhur në këtë kuvend me pas mujtë me marr unë vendim nuk ishim ardhur këtu, kemi kërkua me mirëkuptim që të mbahet kjo seancë e kuvendit, ne e dimë që kuvendi është me i lartë, nuk ka asgjë klandestine, qëllimi kësaj radhe që të mos bëjmë politik por të ndihmojmë qytetarëve, është gjëja më e vogël që mundemi të bëjmë, nëse kemi baze ligjore kuvendi komunal nuk mundet ta shkel ligjin sepse ligji i ka normat tatimore por ministri ka deklaruar se do të marrin për baze rekomandimet e komunave dhe të dërgohet Kuvendit të Kosovës, prandaj ne nuk mundemi të marrim vendim sepse ligji duhet të shfuqizohet për me u bë ligji i ri, sot jam i zhveshur nga petku politik, e kemi këtë mundësi me bë, e kemi këtë iniciativë të marrim këtë rekomandim, sepse kemi zotim publik nga një institucion që do të realizoj këto kërkesa.

Kryetari i Komunës - tha se mendon se rekomandimi i dytë që u cek nuk ka asgjë kundër, se të dy alternativat janë të mira, sepse kjo është në të mirë të qytetarëve dhe pritet përpilimi i ri i ligjit dhe ndoshta qeveria do të marr ndonjë udhëzim administrativ që të vazhdohet me borxhet e vitit 2022.

Ajet Berisha- grupi iniciues grupi parlament i opozitës që falja të bëhet deri 100.00 € për vitin 2023 për faturat e tatimit në prone por jo borxhet e viteve paraprake, e dyta ka ardhur edhe rekomandimi nga ministria, se janë gjet në një pozitë jo të mirë se edhe reagimi ka qenë bukur i madh i publikut, ka ardhur një rekomandim që të sugjerohet kuvendeve komunal që po e bëjmë ne dhe të shkoj kuvendit të Kosovës ndërsa ministri e gjene rrugën e vet ligjore deri në kuvend, se për ligjin aktual do të ketë një amendament për falje, duke qenë se ne dëshirojmë të ndihmojmë qytetarit për faljen e borxhit ndërsa të fusim rekomandime tjera veç e komplikojmë prandaj kish qenë mirë me shku me rekomandimin e parë. Në rast se vlen fjala e kryetarit se kjo nuk ndikon në investime të projekteve prandaj ne po zbatojmë propozimin e ministrit ndërsa ministria le të kryen gjegjësisht le të mbetet topi në duart e tij, ai e procedon me tutje. Ne nuk mundemi të ndikojmë të ligji sepse ligji e përcakton por pasi ministri ka kërkuar vet, ne veç po e zbatojmë.

Sami Ahmeti- sa është seancë e jashtëzakonshme vetëm dua të plotësoj njeri tjetrin sa i përket propozimit të parë ne jemi në dakord ndërsa propozimi i dytë është kontradiktore me të parin, për faktin se të parin po kërkon që qytetarit të falet borxhi ndërsa me të dytin kërkohet që të taten sikurse në vitin 2022, prandaj nuk dimë apo falen apo taten. Unë propozoj që të shkohet me propozimin e parë dhe na këtu jemi, mundemi prapë edhe mas dy jave të marrim rekomandime sepse është zotim publik ky është qëllimi dhe të na e sheh hajrin qytetari, ndërsa nëse duam të vendosim pengesa kjo nuk funksionon.

Enver Gashi- rekomandimin e dytë e kemi marr aq drastike çka ka të keqe për rekomandimin e dytë apo veç kemi propozua ne, Ligji menjë vendim pezullohet por të punohet ligji ka punë. Nuk ka asgjë të keqe, ne shkojmë me propozimet tona.

Kryesuesja – i lexon propozimet dhe njëherit i arsyeton, prandaj i pyet të pranishmit për këto dy rekomandime

Ajet Berisha – po gabon kryesuesja, te shkohet me rekomandimin e pare nga grupi iniciues me 8 nënshkrime dhe i dyti nga grupi

Sami Ahmeti-pajtohem me riformulimin e rekomandimit te pare qe e citoj Enveri ndërsa i dyti rekomandim le te shkohet me votimin gjegjesisht dy propozime.

Kryesuesja- propozon te shkohet me votim sipas propozimeve te grupeve sepse grupi i IQO-se nuk pranon ndarjen e propozimeve te tyre.

Propozimi i grupit iniciues -propozimi i pare - 7 vota "Për" dhe 10 vota "Kundër" - ndërsa


Propozimi i dyte me dy rekomandime - 10 vota "Për" dhe 7 vota "Kundër"

Pas votimit u mor ky

REKOMANDIM

3. Qe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve te plotësoj infrastrukturën ligjore, ku Komuna e Obiliqit është e gatshme për lirim të pagesës, sipas faturave të qytetarëve nga tatimi në pronën e paluajshme deri në 100 euro.
4. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, vendimi për Ri-vlerësimin e pronave ta pezulloj dhe qytetarët të paguajnë vlerën e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023 ashtu si ka paguar në vitin 2022.

Takimi përfundoi në ora 10:42.

Procesmbajtësja

S. Hashani

